



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2189 Më 16.06 2023
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

**THIRRJE PUBLIKE PËR PUNË PRAKTIKE ME PAGESË NË
PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT**

Qershor, 2023

Qëllimi

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në bashëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, organizojnë “Praktikë me pagesë në Partneritet Publiko-Privat”. Praktika do të zgjasë 6 muaj dhe do të jetë me bashëfinancim në mes të komunës së Rahovecit dhe sektorit privat.

Kriteret e përgjithshme për aplikim

Të drejtë aplikimi kanë të rinjtë:

1. Nga mosha **18** vjeç deri në moshën **30** vjeçare.
2. Nxënës të cilët kanë përfunduar minimum mësimet e shkollës së mesme, në profile të ndryshme si dhe
3. Studentë të cilët vijnë studimet apo të diplomuar në nivelin Bachelor apo Master (drejtimet e specifikuara më poshtë).

Aplikacioni

Aplikacioni duhet të përmbajë:

- Vërtetimin apo diplomën që kenë përfunduar Shkollën e Mesme të Lartë, që jeni student apo diplomë universitare;
- Ekstraktin e lindjes;
- Çertifikatën e trajnimit ose të praktikës (nëse ka);
- Kopja e CV;
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikueses/it;
- Duhet të specifikohet drejtimi për të cilin aplikon.

Kërkesat e përgjithshme në aplikim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Aplikuesit duhet të kenë këto profesione:

- ✓ Ekonomi
- ✓ Juridik
- ✓ Teknik i farmacisë
- ✓ Teknik i Makinerisë
- ✓ Teknologji Ushqimore
- ✓ Infermieri
- ✓ Inxhinieri Elektrike
- ✓ Teknologji Informative
- ✓ Hidraulik

- ✓ Sanitari
- ✓ Kimi /biologji (laborator)
- ✓ Arkitekturë
- ✓ Dizajn Grafik

Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike

- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të mira të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve.
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës.
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale dhe të pavarura.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Procesi i përzgjedhjes

Aplikimet do të shqyrtohen nga Komisioni vlerësues, i cili i përcjell aplikimet dhe përpilon një listë finale të të kualifikuarve për punë praktike. Nëse vlerësohet e nevojshme, Komisioni mund të zhvillojë intervistë me kandidatët për të përzgjedhur kandidatët e kualifikuar për fillimin e punës praktike.

Thirrja do të jetë e hapur nga data: 15.06.2023 deri me 29.06.2023.
Aplikacionet dorëzohen fizikisht në Administratë, sporteli nr 8.